

PRISHTINË, SHKURT 2021

RAPORT I MONITORIMIT TË KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË 2



RAPORT I MONITORIMIT TË KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË 2

PRISHTINË, SHKURT 2021

Publikues:

ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim

www.orca-ks.org

info@orca-ks.org

Henrik Bariç, Nr. 6

Prishtina, 10000, Kosova

Autorë:

Liridona Ademaj

Skord Retkoceri

Dizajn dhe Layout:

Envinion

Prishtinë, shkurt 2021



“Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë
gojën mbyllur kur s’kemi gjë për të thënë.
Falna durimin të thellojmë një punë përpara
se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një
ndjenë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo
vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu!
Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga
shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e
shtypit. Ashtu qoftë!”

[Faik Konica]

PËRMBAJTJA

Shkurtesa dhe definime	7
Hyrje	8
Çka është Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë?	9
Legjislacioni	10
Procesi i akreditimit/riakreditimit dhe tërheqjes së akreditimit	12
Vendimet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC)	14
Institucionet me dhe pa akreditim institucional	16
Programet studimore të akredituara në Institucione të Arsimit të Lartë ...	18
Numri i programeve studimore të akredituara në IAL	20
Parregullsitë dhe ndërhyrjet në Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe Këshillin Shtetëror të Cilësisë	23
Sfidat e Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe Këshillit Shtetëror i Cilësisë	28
Hapat e radhës	32

SHKURTESA DHE DEFINIME

- **AKA** – Agjencia e Kosovës për Akreditim, është agjenci e pavarur dhe misioni i saj kryesor është vlerësimi dhe akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit
- **KShC** – Këshilli Shtetëror i Cilësisë, është organ politikbërës dhe vendimmarrës i AKA-së, i cili përbëhet nga nëntë anëtarë, tre prej të cilëve janë ndërkombëtarë
- **IAL** – Institucion i Arsimit të Lartë
- **Akreditim** – Njohje formale se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij i plotësojnë standardet ndërkombëtarisht të pranura të cilësisë, përmes të cilit përcaktohet statusi zyrtar i institucionit të arsimit të lartë dhe programeve të tij të studimit për një periudhë kohore
- **ENQA** – Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
- **EQAR** – Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
- **Bartës** – Çdo institucion i themeluar ose organ tjetër i autorizuar për ofrimin e shërbimeve arsimore në nivelin e arsimit të lartë
- **Bartës publik** – Bartës i themeluar nga Qeveria e Republikës së Kosovës
- **Program** – Program studimi që shpie në një kualifikim ose diplomë, që jepet nga një bartës i arsimit të lartë
- **Komision i Ankesave** – Organi i cili trajton dhe shqyrton ankesat e parashtruara ndaj vendimeve të KShC-së, i cili përbëhet nga tre anëtarë të përhershëm dhe dy anëtarë rezervë
- **MASH** – Ministria e Arsimit dhe Shkencës

HYRJE

Agjencia e Kosovës për Akreditim dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë vazhdojnë të përballen me ndërhyrje të njëpasnjëshme dhe sfida të ndryshme gjatë punës së tyre.

Ndërhyrjet politike nga jashtë dhe disa parregullsi nga brenda, kanë ndikuar që cilësia e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit të mos jetë në nivel të kënaqshëm.

Ky raport është rezultat i monitorimit të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), në Agjencinë e Kosovës për Akreditim gjatë vitit 2020.

ORCA ka qenë e pranishme në mbledhjet e mbajtura nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë, përmes të cilave është informuar për të gjitha vështirësitë me të cilat ata janë përballur gjatë punës së tyre.

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka vazhduar me procesin e akreditimit të të gjitha institucioneve të arsimit të lartë publik dhe privat, pavarësisht vështirësive që janë paraqitur që nga marsi i vitit 2020 me shpërndarjen e pandemisë COVID-19 dhe rrezikun për infektim.

Funksionimi më i mirë dhe me efikasitet më të lartë në proceset e vendimmarrjes për akreditimin e institucioneve dhe programeve, mund të arrihet vetëm përmes sigurimit të pavarësisë së plotë të këtij institucioni në mënyrë që AKA të bëhet përsëri pjesë e Rrjetit Evropian të Asociacionit për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).

Agjencisë dhe bordit të saj, i nevojitet krijimi i një ligji të veçantë përmes të cilit do të pamundësohet ndikimi jodirekt i politikave të ministrave të arsimit në detyrë, një staf i mjaftueshëm me të cilët obligimet e agjencisë do të kryheshin më shpejtë dhe më lehtë, krijimi dhe mirëmbajtja e databazave të nevojshme për tregun e punës dhe politikat e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, e shumë të tjera.

ÇKA ËSHTË AGJENCIA E KOSOVËS PËR AKREDITIM DHE KËSHILLI SHTETËROR I CILËSISË?

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) është agjenci e pavarur dhe misioni i saj kryesor është vlerësimi dhe akreditimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

Ajo është përgjegjëse për procesin e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, përcakton standardet dhe harton procedurat e saj për sigurimin e cilësisë në përputhje me legjislacionin vendor dhe standardet ndërkombëtare për cilësi në arsimin e lartë.

AKA përbëhet nga bordi i saj, i njohur si Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), i cili është organ politikbërës dhe vendimmarrës, si dhe strukturë e përhershme administrative e agjencisë.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë përbëhet nga nëntë anëtarë, Gazmend Luboteni, Vjollca Krasniqi, Dukagjin Zeka, Rozafa Koliqi, Arta Basha Jakupi, Binak Beqaj, si dhe nga tre anëtarët tjerë ndërkombëtarë, Jeffery Butel, Magdalena Ziolo dhe Herbert Amato. Anëtarët e KShC miratohen nga Kuvendi i Kosovës, dhe kanë mandat 3 – 5 vjeçar.

KShC merr vendim për akreditim me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të vet, por asnjë vendim i KShC-së për akreditim/riakreditim nuk mund të merret pa pjesëmarrjen e të paktën një anëtari ndërkombëtar.

LEGJISLACIONI

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), vepron duke u bazuar në *Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës*¹, konkretisht me Nenin 7 ‘*Agjencia e Kosovës për Akreditim*’, në të cilin sqarohet se AKA është agjenci e pavarur përgjegjëse për vlerësimin dhe promovimin e cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë, andaj edhe siguron që standardet dhe cilësia e arsimit të lartë të plotësojë kërkesat dhe pritjet e Rrjetit Evropian të Asociacionit për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

AKA është përgjegjëse për inspektimin e bartësve të arsimit të lartë dhe këshillimin me Ministrinë e Arsimit lidhur me dhënien, ndryshimin ose anulimin e licencave, kryerjen e kontrolleve periodike mbi cilësinë e bartësve të licencuar të arsimit të lartë dhe marrjen e vendimit për akreditimin apo riakreditimin e tyre, vlerësimin periodik të cilësisë së programeve të ofruara nga bartësit e akredituar, si dhe shpalljen e politikave, kriterëve dhe standardeve për akreditim.

*Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës*², përcakton kompetencat e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, kërkesat dhe procedurat për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

AKA funksionon edhe me *Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC)*³, përmes të cilës përcaktohet funksionimi, përbërja, mënyra e marrjes së vendimeve, detyrat dhe mënyra e punës së këtij këshilli. Në Nenin 7 të kësaj rregulloreje, ‘*Përgjegjësitë dhe funksionet e KShC-së*’, thuhet se KShC përcakton objektivat kryesore dhe afatet kohore të procesit të vlerësimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), miraton Standardet, Procedurat dhe Kriteret e vlerësimit të jashtëm të IAL-ve të hartuara nga AKA.

Ky këshill, gjithashtu harton dhe miraton statutin e AKA-së, rregulloret dhe dokumentet tjera të nevojshme për funksionimin e Agjencisë.

¹ Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, shtator 2011, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

² Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, shtator 2018, linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/10/ilovepdf-merged.pdf>

³ Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), qershor 2018, linku: <https://drive.google.com/file/d/0B7etG3bh-SBVVkt4T2J5bmZuOTdYVFN4bFZmMnFwax3Z0tR/view>

Në *'Rregulloren mbi punën e Komisionit të Ankesave'*⁴, përcaktohen rregullat dhe procedurat e shqyrtimit të ankesave, si dhe rregullohet puna, organizimi dhe kompetencat e Komisionit të Ankesave. Neni 4 i kësaj rregullore, *'E drejta e ankesës'*, sqaron se palët mund të paraqesin ankesë nëse vendimi është marrë si rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedurën e marrjes së vendimit të KShC-së, në rast të zbatimit të gabuar të ligjit material apo rregullave materiale të zbatueshme dhe nëse vendimi nuk bazohet në faktet dhe provat e prezantuara.

Në *Udhëzimin Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për akreditimin e institucioneve të Arsimit të lartë*⁵, në Nenin 2, është shtuar paragrafi ku thuhet se IAL-ve të cilave u është refuzuar apo tërhequr akreditimi institucional apo i programeve të studimit, mund të aplikojnë përsëri brenda periudhës prej 90 ditëve nga pranimi i vendimit përfundimtar. Gjithashtu i është lejuar AKA-së, që të verifikojë të dhënat e paraqitura nga IAL-ët në çdo kohë, pa qenë nevoja që IAL-ët të jenë në proces vlerësimi për akreditim ose riakreditim.

Ndërkohë që edhe në *Udhëzimin administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për plotësimin dhe ndryshimin e UA për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë*⁶, është shtuar se stafi akademik i cili është i deklaruar brenda institucionit sipas afateve ligjore edhe ata të cilët nuk janë deklaruar në asnjë IAL, kanë të drejtën e riaplikimit në afat prej 90 ditësh pas marrjes së vendimit përfundimtar refuzues.

4 Rregulloren mbi punën e Komisionit të Ankesave, 2019, linku: http://akreditimi-ks.org/docs/LawRegulation/Rregullorja_e_komisionit_te_ankesave.pdf

5 Udhëzim Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, gusht 2019, linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/05/ua-masht-08-2019-per-ndryshim-dhe-plotesim-te-ua-nr-15-18.pdf>

6 Udhëzim administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për plotësimin dhe ndryshimin e UA për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, korrik 2019, linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/07/4dd5f6a7-x.pdf>

PROCESI I AKREDITIMIT/ RIAKREDITIMIT DHE TËRHEQJES SË AKREDITIMIT

Akreditimi mund të bëhet në nivelin e institucionit të arsimit të lartë, programit të studimit, degës dhe programeve të studimit të cilat ofrohen në atë degë dhe njohjes së akreditimit valid ndërkombëtar. Kërkesën për akreditim mund ta bëjë vet institucioni i arsimit të lartë, për nivelin e institucionit dhe programeve të tij të studimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në raste specifike.

Akreditimit fillestar i nënshtrohet secili institucion, i cili pretendon të ofrojë arsim të lartë në Kosovë, ndërkohë që riakreditimit, i nënshtrohen institucionet e akredituara të arsimit të lartë në baza periodike.

Institucioni i Arsimit të Lartë (IAL), i cili aplikon për akreditim/riakreditim, duhet të dorëzojë kërkesën për akreditim bashkë me listat e stafit akademik, për të cilat KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program studimi.

Nëse vlerësimi preliminar nga KShC është pozitiv, nënkuptohet se aplikacioni i plotëson kushtet formale sipas akteve juridike në fuqi duke autorizuar drejtorin e AKA-së, për zhvillim të procedurave për procesin e vlerësimit dhe akreditimit. Ndërkaq nëse vlerësimi preliminar është negativ dhe KShC konstaton se aplikacioni ka mangësi dhe nuk i plotëson kushtet formale, atëherë KShC merr vendim për refuzim të aplikacionit.

Pas aprovimit të listës së stafit akademik dhe aplikacionit, AKA pranon një raport të vetëvlerësimit nga institucioni përkatës, të cilin pastaj do t'ia përcjellë ekipit të vlerësuesve të jashtëm ndërkombëtarë. Ky ekip shkruan një raport të jashtëm të vlerësimit të cilësisë së institucionit aplikues apo të programeve të tij të studimit, duke u bazuar në standardet dhe udhëzuesit për akreditim, në të cilin ofrohet edhe rekomandimi final për riakreditim apo mosakreditim. Pas vlerësimit të këtij raporti, KShC vendosë për akreditim/riakreditim apo ta refuzojë.

AKA-së i lejohet trajtimi i këtyre aplikacioneve në periudhë prej një viti, prej datës së pranimit të kërkesës për akreditim ndërkaq kërkohet që këto aplikacione, të dorëzohen në Agjenci më së largu me 31 tetor.

Akreditimi institucional fillestar është për tri vite dhe riakreditimi jo më shumë se pesë vite, përveç rasteve kur ekipi i vlerësuesve të jashtëm rekomandon një kohëzgjatje tjetër e cila merr pajtimin e bordit të KShC-së. Ndërkohë, kohëzgjatja e riakreditimit të programit studimor, është tri deri në pesë vite, pos rasteve me rekomandim ndryshe.

AKA mund ta tërheq vendimin e saj për akreditim në çfarëdo kohe, nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur, nëse aplikuesi ka dorëzuar informata dhe dokumente të rreme të cilat kanë ndikuar në dhënien e akreditimit, si dhe nëse raporti i monitorimit nga vlerësuesit ndërkombëtarë konstaton se rekomandimet e vlerësuesve të jashtëm nuk janë zbatuar dhe gjendja faktike në institucion është dëmtuar rëndë në aspektin e cilësisë.

Komisioni i Ankesave shqyrton ankesat e parashtruara nga IAL-ët kundër vendimeve të KShC-së dhe nxjerr vendim brenda 30 ditësh nga data e dorëzimit të tyre.

VENDIMET E KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË (KSHC)

Gjatë vitit 2020, janë dhënë 12 vendime negative nga KShC për refuzim të akreditimit të programeve dhe institucioneve, ku prej tyre 8 vendime janë për akreditime institucionale të Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) privat, si dhe 4 janë vendime për programe të disa prej Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) privat.

Në këtë periudhë kohore, KShC i ka dhënë riakreditim institucional gjithsej 4 Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), 1 private dhe 3 publike. Ndërkohë ka refuzuar riakreditimin institucional për 4 IAL private.

Mes tyre janë Kolegji FAMA, Kolegji Iliria dhe Kolegji Tempulli, të cilat si Institucione të Arsimit të Lartë privat, kanë dështuar për herë të dytë në procesin e akreditimit institucional.

Sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës⁷, Neni 14 'Licencimi i bartësve të arsimit të lartë', në pikën 4 dhe 6 thuhet se parakusht kryesor për licencim të bartësve të arsimit të lartë është akreditimi nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe se bartësi konsiderohet i licencuar përveç nëse ai dështon në plotësimin e standardeve të AKA-së për akreditimin institucional.

Ndërkohë që sipas Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës⁸, në Nenin 18 'Vendimi për akreditim', pika 11 thuhet se nëse institucioni i arsimit të lartë dështon të riakreditohet për herën e dytë, AKA do të njoftojë MASHT për të proceduar tutje me tërheqjen e licencës së institucionit.

Nëse e krahasojmë me numrin e akreditimit të programeve para emërimit të bordit i cili ishte funksional gjatë vitit 2020, rezulton se në marrjen e mandatit ky bord kishte gjetur të akredituara 220 programe të IAL-ve publike dhe 122 programe të IAL-ve private. Numri i programeve studimore me akreditim gjatë vitit 2020 në IAL publike është 233, ndërsa në IAL private është 128.

⁷ Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, shtator 2011, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

⁸ Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, tetor 2018, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=17952>

Ndërkohë që në vitin 2020, me akreditim institucional ishin 9 IAL publike dhe 12 IAL private, ndërsa pa akreditim institucional gjatë këtij viti, ishin 10 IAL private. Mirëpo nëse e krahasojmë me vitin 2018, kur edhe e kishte filluar punën bordi i tanishëm, me akreditim institucional ishin gjithsej 9 IAL publike dhe 21 IAL private.

Gjatë kësaj periudhe kohore, AKA ka pranuar një padi gjyqësore për një program studimi në një IAL private. Kjo ka ndodhur për shkak të refuzimit për akreditim të një programi, ndërkohë që rekomandimi i ekspertëve ka qenë që programi të akreditohej. Sipas legjislacionit në fuqi, KShC mund të marr vendim ndryshe prej rekomandimit të ekspertëve vetëm në rastet kur konstaton se gjendja faktike e raportit nuk është në përputhje me rekomandimin final të vlerësuesve të jashtëm.

Komisioni i Ankesave

Në shtator të vitit 2020, Agjencia e Kosovës për Akreditim kishte emëruar pesë anëtarë të Komisionit të Ankesave (KA)⁹. Tre anëtarë janë të përhershëm dhe dy anëtarë janë rezervë apo alternativë.

Anëtarët e përhershëm janë Faton Merovci, Muhamet Qerimi dhe Krenare Sogojeva Dërmaku, ndërkohë që anëtarët rezervë janë Bujar Pira dhe Haki Demolli. Ky komision ka mandat dy vjeçar.

Komisioni i Ankesave ka trajtuar gjithsej 15 ankesa gjatë vitit 2020, 14 nga IAL-të private dhe 1 nga IAL-të publike. 13 ankesa janë refuzuar si të pabazuara dhe janë vërtetuar vendimet e KShC-së, ndërkohë që 1 ankesë është pranuar si e bazuar dhe 1 ankesë është pranuar si pjesërisht e bazuar.


⁹ Lajm/Themelohet Komisioni i Ankesave i Agjencisë së Akreditimit, shtator 2020, linku: <https://kallxo.com/lajm/dokument-themelohet-komisioni-i-ankesave-i-agjencise-se-akreditimit/>

INSTITUCIONET ME DHE PA AKREDITIM INSTITUCIONAL

INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË



Me akreditim:



Pa akreditim:

- ✓ Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
- ✓ Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”
- ✓ Universiteti i Pejës “Haxhi Zeka”
- ✓ Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”
- ✓ Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj
- ✓ Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”
- ✓ Universiteti i Gjilanit “Kadri Zeka”
- ✓ Akademia e Kosovës për Siguri Publike
- ✓ Fakulteti i Studimeve Islame

INSTITUCIONET PRIVATE TË ARSIMIT TË LARTË



Me akreditim:



Pa akreditim:

✓ Kolegji AAB

✓ AUK (RIT Kosovo)

✓ Kolegji Dardania

✓ Kolegji ESLG

✓ Akademia Evolucion

✓ International Business College Mitrovica (IBC-M)

✓ Kolegji Heimerer

✓ Kolegji Rezonanca

✓ Kolegji Riinvest

✓ Kolegji UBT

✓ Kolegji Universum

✓ Kolegji ISPE

⊖ Kolegji Biznesi

⊖ Kolegji Fama

⊖ Kolegji Globus

⊖ Kolegji Iliria

⊖ Kolegji Juridica

⊖ Kolegji Tempulli

⊖ Kosovo Art Academy

⊖ Kolegji "Pjetër Budi"

⊖ Kolegji Dukagjini

⊖ Kolegji Universi

⊖ Kolegji Arbëri

PROGRAMET STUDIMORE TË AKREDITUARA NË INSTITUCIONE TË ARSIMIT TË LARTË

Programet studimore me akreditim në IAL publike sipas nivelit të studimeve¹⁰ janë si më poshtë;

KShC ka akredituar gjithsej 124 programe të nivelit Bachelor, 47 të nivelit Bachelor i Arteve, 65 të nivelit Bachelor i shkencës, 2 prej të cilave janë të nivelit Bachelor i Arteve (Profesional), 5 të nivelit Bachelor i Juridikut, 2 të nivelit Bachelor i Muzikës, 1 të nivelit doktor i Mjekësisë Veterinare (Integruar), 1 të nivelit doktor i mjekësisë dentare (Integruar) dhe 1 të nivelit doktor i mjekësisë (Integruar).

Ndërsa në nivelin Master, KShC ka akredituar gjithsej 91 programe studimore, 28 të nivelit Master i Arteve, 51 të nivelit Master i shkencës, 1 të nivelit Master i Arteve (Profesional), 1 të nivelit Master profesional, 7 të nivelit Master i Juridikut, 2 të nivelit Master i Muzikës, 1 të nivelit Master i Shëndetësisë Publike dhe 1 të nivelit Master i Shëndetësisë Publike (Integruar).

Në nivelin e doktoratës, KShC ka akredituar 14 programe, në nivelin doktor i shkencës janë akredituar 5 programe.

Nëse e krahasojmë me raportin e vitit të kaluar¹¹, këtë herë kemi më shumë programe të akredituara në IAL publike meqenëse tri universitetet publike tashmë kanë marr akreditim institucional dhe rrjedhimisht programet që kanë pasur akreditim iu është mundësuar që të regjistrojnë studentë, si dhe u është dhënë akreditim edhe programeve të tjerave të cilat nuk kanë pasur akreditim.

Gjatë vitit 2019, në IAL publike kanë qenë të akredituara gjithsej 81 programe të nivelit Bachelor, 72 të nivelit Master, 14 të doktoratës dhe 5 në nivelin doktor i shkencës. Ndërkaq për vitin 2020, në IAL publike kanë pasur akreditim gjithsej 124 programe në nivelin Bachelor,

¹⁰ Lista me programe të akredituara nga IAL publike dhe private, 2020, linku: <https://drive.google.com/file/d/14EwqBrL5Kp1gdzsgDL7rVdfnQxaaq0CO/view>

¹¹ Raporti i Monitorimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë, mars 2020, linku: <http://orca-ks.org/wp-content/uploads/2017/02/Raporti-Monitorimit-te-Keshillit-Shteteror-06.pdf>

91 në nivelin Master, 14 në doktoratë dhe 5 në nivelin doktor i shkencës. Pra, gjatë vitit 2020, është shtuar numri i programeve të akredituara në nivelin Bachelor për 43 dhe në nivelin Master për 19 programe.

Programet studimore me akreditim në IAL private sipas nivelit të studimeve¹² janë si më poshtë;

Në nivelin e pestë, i cili është shkollë e lartë profesionale, KShC kishte akredituar një program.

KShC ka akredituar gjithsej 87 programe të nivelit Bachelor, 38 të nivelit Bachelor i Arteve, 38 të nivelit Bachelor i shkencës, 1 të nivelit Bachelor i Arteve (Profesional), 3 të nivelit Bachelor profesional, 4 të nivelit Bachelor i Juridikut, 2 të nivelit doktor i mjekësisë dentare dhe 1 të nivelit doktor i mjekësisë dentare (Integruar).

Ndërsa në nivelin Master, KShC ka akredituar gjithsej 40 programe studimore, 17 të nivelit Master i Arteve, 15 të nivelit Master i shkencës, 1 të nivelit Master i Arteve (Profesional), 6 të nivelit Master i Juridikut dhe 1 të nivelit Master i Shëndetësisë Publike.

Numri i programeve të akredituara për vitin 2020, është rritur për 8 programe në IAL private. Është shtuar për 10 numri i programeve në nivelin Bachelor i shkencës, ndërsa në nivelet tjera ka pasur lëvizje për një apo dy programe.

¹² Lista me programe të akredituara nga IAL publike dhe private, 2020, linku: <https://drive.google.com/file/d/14EwqBrL5Kp1gdzsgDL7rVdfnQxaaq0CO/view>

NUMRI I PROGRAMEVE STUDIMORE TË AKREDITUARA NË IAL

Lloji i diplomës	Publik	Privat	Total
Bachelor i Arteve	47	38	85
Bachelor i Shkencës	65	38	103
Bachelor i Arteve (Profesional)	2	1	3
Bachelor Profesional	0	3	3
Bachelor i Juridikut	5	4	9
Bachelor i Muzikës	2	0	2
Doktor i Mjekësisë (integruar)	1	0	1
Doktor i Mjekësisë Dentare (integruar)	1	1	2
Doktor i Mjekësisë Dentare	0	2	2
Doktor i Mjekësisë Veterinare (integruar)	1	0	1
Master i Arteve	28	17	45
Master i Shkencës	51	15	66
Master i Arteve (Profesional)	1	1	2
Master Profesional	1	0	1
Master i Juridikut	7	6	13
Master i Muzikës	2	0	2
Master i Shëndetësisë Publike	0	1	1
Master i Shëndetësisë Publike (integruar)	1	0	1
Niveli i pestë	0	1	1
Doktoratë	14	0	14
Doktor i Shkencës	5	0	5
TOTAL	234	128	362

Vlerësimi i institucioneve të arsimit të lartë nga Agjencia e Kosovës për Akreditim

Vlerësimi i institucioneve të arsimit të lartë nga ekspertët ndërkombëtar është bërë kryesisht gjatë muajit maj të vitit 2020. Në këtë vit procesit të akreditimit i janë nënshtruar 14 institucione të arsimit të lartë:

IAL-të publike:	IAL-të private:
Universiteti i Prishtinës	Kolegji Iliria
Universiteti i Ferizajt	Kolegji UBT
Universiteti i Prizrenit	Kolegji Pjetër Budi
Universiteti i Pejës	Kolegji Fama
Universiteti i Mitrovicës	Kolegji Dukagjini
	Kolegji Tempulli
	Kolegji Biznesi
	Kolegji Arbëri
	Kolegji Universi

Për shkak të rrethanave të emergjencës shëndetësore të COVID – 19, Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka marrë vendim që AKA të zbatojë procesin e akreditimit në distancë. Këtë e ka lejuar Ministria e Arsimit dhe Shkencës përmes vendimit nr. Ref: 35/01B.

Procesi i vlerësimit ka qenë vetëm pjesërisht online, pasi që në çdo vizitë në institucionet e arsimit të lartë kanë qenë të pranishëm fizikisht të paktën dy përfaqësues të agjencisë. Nga 14 vizita, në 12 prej tyre ka marrë pjesë edhe drejtori i agjencisë.

Në procesin e vlerësimit të institucioneve kanë qenë të angazhuar gjithsej 9 ekspertë. Bazuar në rekomandimin e ENQA-s, 3 nga ekspertët janë ekspertë studentë. AKA ka ndarë ekspertët në tri grupe. Secili grup i përbërë nga 3 ekspertë ka vlerësuar 2 IAL publike dhe 3 IAL private.

Ekipi i ekspertëve është përbërë nga: Melita Kovaçević, Maiki Udam, Oana Sarbu, Milan Pol, Janez Vogrinz, Ketil Tsofniasvili, Yelena Istileluova, Elene Jibladze, Delia Gologan.

Në vizitat në IAL, përfaqësues të agjencisë dhe ekipi i ekspertëve kanë zhvilluar takime me menaxhmentin e institucionit, me zyrtarë për sigurim të cilësisë, me kryesues të programeve studimore si dhe me staf mësimdhënës. Po ashtu, takim ka pasur edhe me studentë, të diplomuar dhe me disa punëdhënës të të diplomuarve. Pas këtyre takimeve, ka pasur një takim të brendshëm vetëm me ekipin e ekspertëve dhe AKA-në. Vizita ka përfunduar me një takim përmbyllës me menaxhmentin e institucionit.

Pasi që ekspertët nuk kanë qenë fizikisht në objektet e IAL-ve, identifikimi i hapësirave dhe pajisjeve është bërë përmes video materialeve të përgatitura nga IAL-të. Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë i kanë marrë në shqyrtim të gjitha materialet, përfshirë edhe raportet e vetëvlerësimit, kanë kërkuar dokumentet shtesë dhe më pas kanë dorëzuar draft raportin. Pas adresimit të komenteve në raport, ekspertët në fund kanë dorëzuar raportin përfundimtar.

PARREGULLSITË DHE NDËRHYRJET NË AGJENCINË E KOSOVËS PËR AKREDITIM DHE KËSHILLIN SHTETËROR TË CILËSISË

Përfshirja nga ENQA dhe EQAR

Agjencia e Kosovës për Akreditim ishte përfshirë nga Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR) në vitin 2018 dhe nga Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) në vitin 2019¹³, si pasojë e ndërhyrjeve politike në pavarësinë e agjencisë.

ENQA kishte kritikuar agjencinë për mospunësimin e zyrtarëve të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve që ofron AKA, zhvillimin e planit strategjik, metodologjinë e punës, përfshirjen e studentëve, monitorimin e zbatimit të standardeve, përmirësimin e cilësisë së raporteve me analiza më të thella dhe pavarësinë e veprimit.

Tejkalimi i kuotave në regjistrimin e studentëve

Në janar të vitit 2020, Inspektorati i Arsimit në MASH kishte bërë kallëzim penal ndaj Kolegjit UBT në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe ishin hapur hetime nën dyshimin se kishin tejkaluar numrin maksimal të regjistrimit të studentëve në programe studimi¹⁴.

Ndërsa në qershor të po atij viti, është dorëzuar një peticion me 293 nënshkrime të studentëve të Kolegjit Heimerer tek sekretari i përgjithshëm në Ministri të Arsimit, pasi kishin verifikuar në po të njëjtën ministri se nuk ishin të regjistruar si studentë në Sistemin e Menaxhimit të Informatave për Arsimin e Lartë (SMIAL).

¹³ Raporti i rishikimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga ENQA, shtator 2019, linku: <https://enqa.eu/wp-content/uploads/2019/10/KAA-external-review-report.pdf>

¹⁴ Hulumtim/Prokuroria nis hetimet ndaj Kolegjit UBT, regjistroi 1236 studentë më shumë, janar 2020, linku: <https://frontonline.net/prokuroria-nis-hetimet-ndaj-kolegjit-ubt-regjistroi-1236-studente-me-shume/>

Regjistrimi i studentëve në programe pa akreditim

Gjatë vitit 2020, është publikuar një hulumtim nga një medium përmes të cilit është publikuar rrëfimi i një studenteje të Kolegjit Rezonanca, e cila pretendonte se ishte mashtruar nga ky kolegji se kishin akreditim në programin ku ajo ishte regjistruar¹⁵.

Kolegji kishte deklaruar se besonte që KShC do t'iu jepte akreditim për vitin akademik 2019/2020 meqenëse u lejohet riaplikimi sipas udhëzimit administrativ të ri dhe nëse nuk u jepej akreditim për atë vit akademik, ata do ta padisnin këtë institucion. KShC nuk kishte akredituar programin e kërkuar nga kolegji në fjalë për vitin akademik 2019/2020 por vetëm për vitin akademik 2020/2021.

Presioni nga ish-kryeministri për përshejtim të procesit për akreditim

Në janar të vitit 2020, ish-kryeministri Ramush Haradinaj, përsëri kishte tentuar të ndërhyjë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim¹⁶, përmes një letre të cilën ia kishte dërguar kryetarit të KShC-së, dhe ish-ushtresit të detyrës së drejtorit të AKA-së, në të cilën akuzonte AKA-në për procedura të tejzgjatura dhe pengesa administrative në procesin e akreditimit për disa kolegje private.

Pas kësaj letre, kishte reaguar drejtori i Regjistrat Evropan për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e lartë (EQAR), Colin Tück, i cili i kishte bërë thirrje bordit të AKA-së që të kenë kujdes se si e shqyrtojnë këtë letër¹⁷, duke shtuar se veprimet e AKA-së mund të rishikohen vetëm nga gjykata.

Dyshime për manipulim të procesit të akreditimit

Tre anëtarë vendorë të KShC-së, Dukagjin Zeka, Arta Jakupi dhe Rozafa Koliqi, ishin larguar nga mbledhja e mbajtur në janar të vitit 2020, nën dyshimet se procesi i akreditimit të disa programeve studimore nga tri kolegje private ishte manipuluar¹⁸.

Kryetari i KShC-së, Gazmend Luboteni¹⁹ dhe ish-ushtresi i detyrës së drejtorit të AKA-së, Avni Gashi kishin mohuar se procesi për akreditim të disa programeve nga Kolegji

15 Hulumtim/ Kolegji Rezonanca tregon pse i nisi studimet në programet që nuk ishin akredituar, janar 2020, linku: <https://kallxo.com/lajm/kolegji-rezonanca-tregon-pse-i-nisi-studimet-ne-programet-qe-nuk-ishin-akredituar/>

16 Lajm/Haradinaj i përzihet sërish punëve të Agjencisë së Akreditimit, janar 2020, linku: <https://kallxo.com/lajm/dokument-haradinaj-i-perzihet-serish-puneve-te-agjencise-se-akreditimit/>

17 Lajm/EQAR-i, i shqetësuar me veprimet e qeverisë së kaluar, kërkon kujdes, shkurt 2020, linku: <https://www.koha.net/arberi/209066/eqar-i-i-shqetesuar-me-veprimet-e-qeverise-se-kaluar-kerkon-kujdes/>

18 Lajm/Dyshime për dallavere në akreditimin e programeve të disa kolegjeve private, janar 2020, linku: <https://www.koha.net/arberi/204577/dyshime-per-dallavere-ne-akreditimin-e-programeve-te-disa-kolegjeve-private/>

19 Me 4 shkurt 2021, kryetari, nënkryetari dhe tre anëtarët ndërkombëtar kanë dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre në Këshillin Shtetëror të Cilësisë. Përdërisa anëtarët ndërkombëtar kanë dhënë dorëheqje për shkak se nuk kanë pranuar të deklarojnë pasurinë e tyre në Agjencinë Kundër Korrupsion, anëtarët vendor kanë dhënë dorëheqje

Rezonanca, Kolegji Heimerer dhe Kolegji ISPE ishte manipuluar²⁰, por anëtarët e KShC-së që kishin ngritur këto dyshime, pohonin se raportet e vlerësimit për programet e këtyre kolegjeve ishin bërë në afat rekord.

Në mars të këtij viti, tre anëtarët e lartpërmendur kishin dorëzuar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë për keqpërdorim të detyrës zyrtare ndaj ish-drejtorit të agjencisë, Avni Gashi, kryetarit të KShC-së, Gazmend Luboteni dhe nënkryetares, Vjollca Krasniqi.

Mirëpo në qershor, Prokuroria kishte rrëzuar kallëzimin penal me arsyetimin se nuk ishin gjetur prova²¹. E sipas parashtresave të këtij kallëzimi penal, kjo ka ndodhur për shkak të vonesës së shqyrtimit dhe vendimit nga ana e prokurorisë, meqenëse deri në kohën kur është marrë vendimi, të gjitha pikat e ngritura në aktakuzë ishin plotësuar.

Odiseada e kërcënimeve dhe presionit ndaj drejtorit të AKA-së

Në prill të vitit 2020, drejtori i Agjencisë së Kosovës për Akreditim, Naim Gashi kishte denoncuar pronarin e Kolegjit ISPE, Avni Mazreku, në Policinë e Kosovës dhe në Prokurorinë e Shtetit, pasi që nga marrja e pozitës së drejtorit, ishte penguar në punë nga presioni dhe kërcënimet e tij.

Më 4 prill 2020, pak orë pasi që ishte mbajtur mbledhja e KShC-së, drejtori Gashi kishte pranuar mesazhe kërcënuese nga pronari i Kolegjit ISPE, Avni Mazreku, i cili më pas kishte shkuar tek shtëpia e drejtorit të Agjencisë dhe kishte demoluar orënditë e oborrit të tij gjatë kohës kur ai dhe familja e tij nuk gjendeshin në shtëpi. Pas mesazheve kërcënuese dhe sulmit ndaj pronës private, Policia e Kosovës kishte arrestuar Avni Mazrekun dhe e kishte dërguar në mbajtje për 48 orë. Rasti tani ndodhet në procedurë të rregullt gjyqësore.

Gjithçka kishte filluar kur pronari i Kolegjit ISPE, bënte presion ndaj Agjencisë së Akreditimit, për akreditimin e dy programeve të studimit, programin 'Infermieri' BSc, për të cilin kishte rekomandim negativ nga ekspertët e jashtëm ndërkombëtarë dhe programin 'Studime të Sigurisë' BA, të cilin bordi i KShC-së kishte refuzuar që ta përfshijë në proces

për shkak të pamundësisë së përmirësimit të cilësisë në arsimin e lartë./Lajm/ Letra e plotë e dorëheqjen së dy anëtarëve vendor të KShC-së, shkurt 2021, linku: <https://kallxo.com/arsim/dokument-letra-e-plote-e-doreheqjes-se-dy-anetareve-vendore-te-kshc-se/>

20 Lajm/Udhëheqësit e akreditimit mohojnë se procesi i akreditimit të kolegjeve është i manipuluar, janar 2020, linku: <https://www.koha.net/arberi/204777/udheheqesit-e-akreditimit-mohojne-se-procesi-i-akreditimit-te-kolegjeve-eshte-i-manipuluar/>

21 Lajm/Rrëzohet kallëzimi penal ndaj drejtuesve të bordit të KShC-së, korrik 2020, linku: <https://kallxo.com/lajm/rrrezohet-kallezimi-penal-ndaj-drejtuesve-te-bordit-te-kshc-se/>

të akreditimit sepse nuk i plotësonte kriteret ligjore për tre bartës të fushës me gradën PhD. Gjithë këto vendime nga AKA dhe KShC ishin marrë në kohën kur Gashi nuk e kishte marrë ende detyrën e drejtorit të Agjencisë.

Kolegji ISPE kishte provuar që ta shantazhojë Agjencinë e Akreditimit, përmes një incizimi të jashtëligjshëm të një takimi me dy zyrtarë të Agjencisë, për të cilin është njoftuar Policia e Kosovës dhe Prokuroria. Në takimin e incizuar jashtëligjshëm, Kolegjit ISPE i ishin sqaruar kriteret që duhet plotësuar për akreditimin e programeve, por ata në vazhdimësi kanë provuar që të bëjnë presion ndaj Agjencisë për të krijuar favore të jashtëligjshme për kolegjin e tyre.

Sekretari i këtij kolegji, Leonis Gashi, kishte vazhduar me presion duke dërguar mesazhe në adresën elektronike të drejtorit të AKA-së, duke e akuzuar për skenarë dhe orkestrime të jashtëligjshme për t'ua pamundësuar akreditimin në një program studimor. Këto mesazhe elektronike janë dërguar në Policinë dhe Prokurorinë e Shtetit dhe do të jenë pjesë e procesit gjyqësor.

Tutje ishin shtuar deklarata të rrejshme që sipas tyre ishin thënë nga drejtori i agjencisë, incizime të bisedave me stafin e kësaj të fundit, mesazhe në adresën elektronike të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare me akuza ndaj drejtorit të agjencisë.

Për këto e shumë të tjera, Naim Gashi ka informuar rregullisht Policinë e Kosovës, të cilët në korrik të vitit 2020 kishin bërë një vlerësim të rrezikshmërisë për drejtorin e Agjencisë së Akreditimit. Pas këtij vlerësimi, Policia e Kosovës kishte ofruar mbrojtje të afërt për drejtorin e Agjencisë dhe ishin vendosur masa të sigurisë për familjen e tij.

Ministri Likaj në mënyrë të jashtëligjshme merr vendim për rritjen e numrit të studentëve në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës

Më 19 nëntor 2020, ministri Ramë Likaj jashtëligjshëm merr vendim për rritjen e numrit të studentëve në Fakultetin e Mjekësisë për vitin akademik 2020/21.²² Sipas Likaj, ky vendim është marrë pas kërkesës së Ministrit të Shëndetësisë, Armend Zemaj, dhe komisionit parlamentar për arsim dhe shkencë, si dhe pas konsultimit me Këshillin Shtetëror të Cilësisë. Megjithatë, komisioni parlamentar për arsim demanton Likaj, duke thënë se ky komision nuk ka propozuar një gjë të tillë.²³ Edhe kryetari i KSHC, Gazmend Luboteni ka deklaruar

²² Lajm/Likaj jashtëligjshëm merr vendim të shtohet numri i studentëve në Mjekësi, nëntor 2020, link: <https://www.koha.net/arberi/246299/likaj-jashteligjshem-merr-vendim-te-shtohet-numri-i-studenteve-ne-mjekesi/>

²³ Lajm/ Eliza Hoxha: Komisioni për Arsim nuk e ka bërë propozimin për rritjen e numrit të studentëve në Mjekësi, nëntor 2020, link: <https://kallxo.com/arsim/eliza-hoxha-komisioni-per-arsim-nuk-e-ka-bere-propozimin-per-rrit->

se KSHC nuk ka qenë e njoftuar për këtë çështje.²⁴ Kundër rritjes së numrit të studentëve ishin edhe Rektori i Universitetit të Prishtinës²⁵ dhe Dekanja e Fakultetit të Mjekësisë.²⁶ Pasi KSHC është organi i vetëm që mund të vendos rreth numrit të studentëve në programet studimore, ky vendim i Ministrit Likaj është i jashtëligjshëm dhe nuk është zbatuar nga Universiteti i Prishtinës.

Ministri në mënyrë të jashtëligjshme emëron Binak Beqaj si anëtar të Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Ministri Likaj në gusht të vitit 2020, emëron në mënyrë të jashtëligjshme Binak Beqaj anëtar në Këshillin Shtetëror të Cilësisë pasi sipas nenit 7, pikës 4 të Ligjit për Arsimin e Lartë, anëtarët e KSHC duhet të ratifikohen nga Kuvendi. Për më tepër Binak Beqaj është anëtar i partisë AAK, ku vjen edhe ministri i arsimit Ramë Likaj²⁷. Kujtojmë se në vitin 2019, Xhavit Rexhaj pati dhënë dorëheqje nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë, pikërisht për shkak se ishte anëtar në parti politike²⁸. Ai kishte bërë pyetje në Agjencisë Kundër Korrupsion të cilët kishin vlerësuar se anëtarët e KSHC nuk duhet të kishin angazhim politik.

Krijimi i grupit punues për trajtimin e problemeve në arsimin e lartë publik dhe privat

Ministri në detyrë, Ramë Likaj, në nëntor të vitit 2020, kishte krijuar një grup punues në të cilin synohej shqyrtimi programeve të paakredituara nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat që nga viti 2010 e tutje.

Synohej që përmes një vendimi të përbashkët të jepej akreditim në mënyrë retroaktive për programet që kishin regjistruar studentë, por të cilat nuk kishin akreditim për një gjë të tillë. Kjo ishte kundërshtuar nga drejtori i Agjencisë për Akreditim dhe kryetari i Këshillit Shtetëror të Cilësisë, andaj edhe propozimet e këtij grupi punues nuk janë zbatuar.

jen-e-numrit-te-studenteve-ne-mjekesi/

24 Lajm/KShC: Ministri nuk është konsultuar me ne për rritjen e numrit të studentëve në Mjekësi, nëntor 2020, link: <https://kallxo.com/lajm/kshc-ministri-nuk-eshte-konsultuar-me-ne-per-rritjen-e-numrit-te-studenteve-ne-mjekesi/>

25 Lajm/Rektori i UP-së kundër kërkesës së Zemajt për rritjen e numrit të studentëve të Mjekësisë, nëntor 2020, link: <https://kallxo.com/lajm/rektori-i-up-se-kunder-kerkeses-se-zemajt-per-rritjen-e-numrit-te-studenteve-te-mjekesise/>

26 Lajm/Kërkesat për rritjen e numrit të studentëve të mjekësisë, Dekanja e Fakultetit i përgjigjet Zemajt, nëntor 2020, link: <https://kallxo.com/lajm/kerkesat-per-rritjen-e-numrit-te-studenteve-te-mjekesise-dekanja-e-fakultetit-i-pergjigjet-zemajt/>

27 Lajm/ Profesori anëtar i AAK-së emërohet në Këshill Shtetëror të Cilësisë, gusht 2020, linku: <https://kallxo.com/lajm/professori-anetar-i-aak-se-emerohet-ne-keshill-shteteror-te-cilesise/>

28 Lajm/ Nuk i lejohet angazhimi partiak, jep dorëheqje anëtari i Këshillit Shtetëror të Cilësisë, maj 2019, linku: <https://kallxo.com/shkurt/nuk-i-lejohet-angazhimi-partiak-jep-doreheqje-anetari-i-keshillit-shteteror-te-cilesise/>

SFIDAT E AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM DHE KËSHILLIT SHTETËROR I CILËSISË

Adresimi i rekomandimeve të ENQA-s

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka zhvilluar Planin e Veprimit për adresimin e rekomandimeve të ENQA-s dhe fushave për zhvillim të AKA-së. Në shtator të 2019-ës, kjo agjenci pranoi vendimin përfundimtar të ENQA-së në të cilin thuhej se AKA-së nuk i ishte vazhduar anëtarësia, me arsyetimin se nuk i përmbushin më standardet, si dhe kishte mangësi të theksuara në udhëheqjen e saj.²⁹ Përveç kësaj, agjencisë i janë ofruar edhe rekomandimet për adresimin e standardeve dhe udhëzimeve për sigurim të cilësisë në zonën evropiane të arsimit të lartë (standardet ESG). Standardet e pa përmbushura plotësisht kryesisht kanë të bëjnë me sigurim të cilësisë, pavarësinë institucionale, resurset, metodologji për arritjen e objektivave, ankesat dhe parashtresat etj.

Për adresimin e rekomandimeve nga ENQA, AKA ka ndërmarrë disa hapa. AKA ka kontraktuar grupin prej katër ekspertëve për draftimin e Planit Strategjik dhe është në fazën finale të draftimit të Manualit për Ekspertë të Jashtëm. AKA po ashtu ka marrë pjesë në draftimin e ligjit për AKA në Ministri të Arsimit dhe Shkencës. Sa i përket numrit të stafit, janë iniciuar procedurat e rekrutimeve të reja.

Vështirësi në verifikimin e bartësve të programeve studimore

Sipas Nenit 26, pikës 5.3.4. të Udhëzimit Administrativ për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, për t'u akredituar një program studimi i nivelit Bachelor dhe Master, duhet që “për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të stu-

²⁹ Raporti i rishikimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim nga ENQA, shtator 2019, linku: <https://enqa.eu/wp-content/uploads/2019/10/KAA-external-review-report.pdf>

dimeve.” Agjencia e Kosovës për Akreditim ka vështirësi në verifikimin e stafit në atë se a janë të angazhuar me orar të plotë edhe në ndonjë institucion tjetër.

Mungesa e databazës për nevojat e tregut të punës

Ende nuk është bërë një dokument/databazë nga ana e Ministrisë së Arsimit³⁰, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale³¹, Agjencisë së Kosovës për Akreditim³², Agjencisë së Statistikave të Kosovës³³ dhe Agjencisë së Punësimit³⁴, i cili analizon nevojat e tregut të punës. Kjo lloj databaze, mund të publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes të cilës të interesuarit për studime universitare, do të informoheshin dhe orientoheshin për programet të cilat i nevojiten tregut të punës. Kjo databazë do t'i shërbente edhe Këshillit Shtetëror të Cilësisë, gjatë procesit të marrjes së vendimit për akreditimin e programeve studimore.

Mungesa e shkëmbimit të informatave për stafin akademik në nivel rajonal

Nevojitet një databazë e tillë, e cila do të shërbente për informimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë Publik dhe Privat, brenda dhe jashtë vendit, për përbërjen e stafit akademik në institucionet e akredituara, në mënyrë që t'u pamundësohet profesorëve që të angazhohen si staf i rregullt, në më shumë se një institucion të arsimit të lartë në shtete të ndryshme. Gjithashtu do t'i shërbente edhe Këshillit Shtetëror të Cilësisë, gjatë procesit të shqyrtimit të stafit akademik të IAL-ve të cilat aplikojnë për akreditim apo riakreditim.

Mungesa e stafit në AKA

Aktualisht AKA funksionon përmes shtatë zyrtarëve; Drejtorit të AKA-së, zyrtares për administratë dhe personel, zyrtares për buxhet dhe financa, zyrtares për monitorim dhe vlerësim, si dhe tre zyrtarëve për vlerësim dhe akreditim. Vështirësitë administrative në proces të rekrutimit, kriteret, ngarkesa e punës në krahasim me pagën e zyrtarëve, cilësia e shqyrtimit të lëndëve, e shumë të tjera, kanë bërë që AKA ende të mos mund ta kompletojë stafin e nevojshëm, gjë që për pasojë nuk kanë arritur të bëjnë procesin e monitorimit të IAL-ve.

30 Faqja zyrtare e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në Republikën e Kosovës, linku: <https://masht.rks-gov.net/>

31 Faqja zyrtare e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Republikën e Kosovës, linku: <https://mpms.rks-gov.net/>

32 Faqja zyrtare e Agjencisë së Kosovës për Akreditim, linku: <http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/>

33 Faqja zyrtare e Agjencisë së Statistikave të Republikës së Kosovës, linku: <https://ask.rks-gov.net/>

34 Faqja zyrtare e Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës, linku: <https://apr.k.rks-gov.net/>

Si pasojë e mungesës së stafit, AKA aktualisht shikon kriteret minimale për akreditimin e programeve studimore dhe akreditimin institucional. Pra bëhet rishikimi i numrit profesor-studentë, sasia e pajisjeve, si dhe hapësira e objektit të IAL-ve. Ndërkohë që kompetencë e AKA-së është edhe shqyrtimi i kërimit shkencor të institucioneve, i politikave për zhvillimin e stafit akademik, i organizimit të brendshëm dhe qasjes së IAL-ve ndaj sigurimit të cilësisë, i monitorimit të progresit të studentëve e shumë të tjera.

Sipas *Ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2020*³⁵, Agjencisë së Kosovës për Akreditim, i është ndarë buxheti për 32 pozita, meqenëse gjatë vitit 2019 ishte ndarë buxhet vetëm për 13 pozita. Tashmë janë iniciuar procedurat për rekrutime të reja në agjenci.

Përmirësimi i infrastrukturës ligjore

Propozohet krijimi i një ligji të veçantë për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, përmes të cilit do të krijohej pavarësi e plotë institucionale, në mënyrë që funksioni i Agjencisë të jetë i përputhshëm me kriteret e Regjistrimit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR) dhe që do t'ia mundësonte AKA-së krijimin e politikave të veta. Si pasojë e mungesës së një ligji të veçantë, MASH ndër vite ka krijuar Udhëzime Administrative që ndikojnë drejtpërdrejtë në punën e AKA-së, siç është shembulli me dy plotësim-ndryshimet e UA-së për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, të cilat ia mundësojnë IAL-ve riaplikimin pas 90 ditësh të marrjes së vendimit refuzues.

Agjencia e Kosovës për Akreditim funksionon në bazë të Udhëzimit Administrativ 15/2018³⁶. Sipas drejtorit të agjencisë, dy plotësimet e këtij udhëzimi, UA 08/2019³⁷ dhe UA 13/2019³⁸, janë miratuar pa përfillur bazën ligjore dhe krijojnë vështirësi të jashtëzakonshme, pasi ekzistojnë rregulla në këto plotësime që janë teknikisht të pamundshme të realizohen.

Drejtori i Agjencisë ka kërkuar nga Ministri i Arsimit, shfuqizimin e UA 08/2019, i cili ua mundëson IAL-ve të aplikojnë për akreditim përsëri në periudhë prej 90 ditësh pas refuz-

³⁵ Ligji mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, linku: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=27690>

³⁶ Udhëzimi Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, shtator 2018, linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/10/ilovepdf-merged.pdf>

³⁷ Udhëzim Administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, gusht 2019, linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/05/ua-masht-08-2019-per-ndryshim-dhe-plotesim-te-ua-nr-15-18.pdf>

³⁸ Udhëzim administrativ për ndryshimin dhe plotësimin e UA për plotësimin dhe ndryshimin e UA për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë, korrik 2019, linku: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2019/07/4dd5f6a7-x.pdf>

imit nga AKA. Kjo bën të pamundur vlerësimin e mirëfilltë, sepse ky afat mund të bie ndesh me afatet kohore për futjen e studentëve në sistemin SMIAL.

Përveç kësaj është kërkuar shfuqizimi edhe i UA 13/2019. Sipas drejtorit të agjencisë, ky plotësim është i paligjshëm dhe mundëson angazhim të stafit jashtë afateve të përcaktuara dhe mundëson angazhim të stafit i cili është i paverifikuar dhe ka marrëdhënie pune në disa institucione të tjera. Kjo procedurë ka krijuar mundësi që stafi i njëjtë, pas procedurave të rregullta të deklarohet në disa IAL.

Agjencia e Kosovës për Akreditim nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në lidhje me këto kërkesa.

HAPAT E RADHËS

Agjencia e Kosovës për Akreditim e ka më se të nevojshme rekrutimin e stafit të nevojshëm për proceset administrative të cilat kryhen nga kjo e fundit.

Gjetja e hapësirave të nevojshme për punën e AKA-së, si një nga rekomandimet e ENQA-s, janë nevojë urgjente me të cilën duhet të merren institucionet e Kosovës.

Krijimi i ligjit të veçantë i cili e rregullon punën e agjencisë, Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe Komisionit të Ankesave në mënyrë që procesi i akreditimit të pavarësohet edhe nga ndikimet e tërthorta të ministrave në detyrë të arsimit, siç është vepruar deri më tash përmes udhëzimeve administrative. Për të garantuar pavarësinë institucionale me ligjin e ri duhet të krijohet edhe pavarësia financiare e AKA-së.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë aktualisht ka mbetur vetëm me katër anëtarë vendorë, ku një prej tyre ende nuk është votuar apo ratifikuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës siç kërkohet përmes legjislacionit të kësaj Agjencie dhe bordi. Pra, është e nevojshme që ky bord të pasurohet me anëtarët e nevojshëm vendorë dhe ndërkombëtarë, në mënyrë që puna e Këshillit Shtetëror të Cilësisë të funksionalizohet, për të vazhduar me proceset e ardhshme gjatë muajve në vazhdim.

Agjencia e Kosovës për Akreditim, aktualisht është në një fazë kritike meqenëse është afruar edhe periudha kohore për të aplikuar për rianëtarësim në Rrjetin Evropian të Asociacionit për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR), pavarësisht se është duke u punuar vazhdimisht që të plotësohen standardet evropiane që kjo të ndodhë.

DEKLARATË E MOHIMIT TË PËRGJEGJËSISË:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim në kuadër të projektit “Cilësi, Llogaridhënie, Integritet dhe Transparencë në Arsimin e Lartë – QAIN”¹. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

WITH FUNDING FROM
 **AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION**


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministristvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology

